

VENDIM
Nr. 204, datë 15.3.2017

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN, DHE TRANSFERIMIN E TIJ NGA MINISTRIA
E ZHVILLIMIT URBAN TE BASHKIA TIRANË, PËR REALIZIMIN E PAGESËS SË
DETYRIMIT TË PRAPAMBETUR PËR SHOQËRINË “URBAPLAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban, të shtohet fondi prej 27 374 082 (njëzet e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e dy) lekësh, në zërin “Studime, projekte”, për pagesën e detyrimit të prapambetur për projektin “Hartimi i planit rregullues të qytetit të Tiranës”.
2. Fondi, sipas pikës 1, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për transferimin e fondit prej 27 374 082 (njëzet e shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë e dy) lekësh te Bashkia Tiranë.
4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave dhe Bashkia Tiranë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama